

**VENDIM**  
**Nr. 21, datë 12.4.2017**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR ZBATIMIN E NËNPROGRAMIT TË MBËSHTETJES FINANCIARE PËR NDËRMARRJET MIKRO, TË VOGLA DHE TË MESME (NMVM)”, PROGRAMI I MBËSHTETJES PËR EKONOMINË, SHTYLLA III**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16 e të aneksit 3, të ligjit nr. 130 datë 15.12.2016, “Për buxhetin e vitit 2017” dhe të nenit 9 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 580, datë 03.08.2016, “Për krijimin e Programit për Mbështetjen e Ekonomisë dhe përcaktimin e përfituesve e rregullave për zbatimin e tij”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

**VENDOSI:**

1. Miratimin e kriterëve të priorizimit të zonave të përmirësuara të biznesit, të pranueshme për aplikim, për thirrjen e parë të vitit 2017, sipas aneksit 1, bashkëlidhur.

2. Miratimin e rregullores “Për zbatimin e Nënprogramit të Mbështetjes Financiare për Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM)”, Programi i Mbështetjes për Ekonominë, shtylla III.

3. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes si edhe Agjencia për Zhvillim Ekonomik Rajonal për zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYETARI**  
**Niko Peleshi**

|                                                                                            |                 |
|--------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------|
| Zëvendëskryeministri                                                                       | Zëvendëskryetar |
| Ministri i Financave                                                                       | anëtar;         |
| Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes                        | anëtar          |
| Ministri i Zhvillimit Urban                                                                | anëtar;         |
| Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës                                                 | anëtar;         |
| Ministri i Arsimit dhe Sportit                                                             | anëtar;         |
| Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave                        | anëtar;         |
| Ministri i Shëndetësisë                                                                    | anëtar;         |
| Ministri i Kulturës                                                                        | anëtar;         |
| Ministri i Mjedisit                                                                        | anëtar;         |
| Ministri i Punëve të Brendshme                                                             | anëtar;         |
| Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike                               | anëtar;         |
| Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore                                                    | anëtar;         |
| Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë                                               | anëtar;         |
| Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë / Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore / |                 |
| Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1                               | anëtar;         |
| Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2                               | anëtar;         |
| Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3                               | anëtar;         |
| Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4                               | anëtar.         |

## ANEKSI 1

Për prioritizimin e zonave të përmirësuara të biznesit, të cilat do të jenë të pranueshme për aplikim, për thirrjen e parë të vitit 2017 për nënprogramin e mbështetjes financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM), Programi i mbështetjes për ekonominë, shtylla III, do të aplikohen kriteret sipas tabelës në vijim:

| <b>Nr</b>      | <b>Kriteret</b>                                       | <b>Vlerësimi</b> |
|----------------|-------------------------------------------------------|------------------|
| 1              | Aplikimi minimal, 10% e bizneseve potenciale të zonës | 1 – 20 pikë      |
| 2              | Zonat të lidhura me zinxhirin e vlerës                | 1 – 20 pikë      |
| 3              | Shkalla e përfundimit të infrastrukturës publike      | 1 – 20 pikë      |
| 4              | Hapësira të lira për njësitë e reja ekonomike         | 1 – 20 pikë      |
| 5              | Bashkëfinancim i donatorëve të tjerë                  | 1 – 20 pikë      |
| <b>TOTALI:</b> |                                                       | <b>100 pikë</b>  |